

Ekskluzive

Ekskluzive | Dorëzohet një tjetër i dyshuar për të shtënat në Mitrovicë – tregon ku e kishte armën, Policia ia gjen pistoletën me fishekë



Sinjali.com

29 Gusht 2026 11:31



Hetimet për përplasjen me armë zjarri që kishte alarmuar Mitrovicën më 9 gusht kanë sjellë një tjetër zhvillim. Njëri nga personat e identifikuar gjatë hetimeve është dorëzuar në Polici, ndërsa pas deklarimit të tij hetuesit kanë arritur të gjejnë dhe sekuestrojnë edhe një armë që dyshohet se lidhet me rastin, raporton ekskluzivisht Sinjali.

Burimet e Sinjalit bëjnë me dije se bëhet fjalë për **Armend Hysenin**, rreth 27-vjeçar, i cili të premten, më 28 gusht, rreth orës 11:50, është paraqitur në Hetimet Rajonale së bashku me avokatin e tij mbrojtës.

Hyseni është intervistuar lidhur me rastin, ndërsa gjatë procedurave ka njoftuar hetuesit për vendndodhjen e armës me të cilën pretendon se e ka kryer veprën.

Ky informacion ka çuar Policinë drejt një kontrolli të ri.

Me urdhër verbal të Prokurorit të Shtetit është kontrolluar shtëpia e të dyshuarit dhe objektet përreth saj. Gjatë kontrollit është gjetur dhe sekuestruar një pistoletë e kalibrit 7.65 mm, bashkë me tre fishekë.

Pas përfundimit të procedurave, me vendim të Prokurorit të rastit, Armend Hyseni është ndaluar për 48 orë.



Lexo edhe

Ekskluzive | Zgjerohet hetimi për shkëmbimin e zjarrit në Mitrovicë – identifikohen edhe dy të dyshuar, njëri arrestohet



Çfarë kishte ndodhur në sheshin “Isa Boletini”?

Rasti për të cilin po zhvillohen hetimet kishte ndodhur më 9 gusht, rreth orës 15:30, në sheshin “Isa Boletini” në Mitrovicë.

Policia ishte alarmuar për të shtëna me armë zjarri dhe, kur kishte mbërritur në vendngjarje, kishte hasur në një skenë që ngriti dyshime për shkëmbim zjarri mes dy palëve.

Në derën e banesës ku ndodheshin disa nga të dyshuarit ishin konstatuar vrima, ndërsa dyshohej se nga brenda banesës ishte qëlluar drejt disa personave që ndodheshin në korridor.

Në korridor ishin gjetur gëzhoja të kalibrave të ndryshëm, duke ngritur dyshimin për përdorimin e të paktën dy armëve. Të dëmtuara kishin mbetur dy dyer të banesave përballë njëra-tjetrës.



Lexo edhe

Ekskluzive | Këta janë të dyshuarit për tentim-vrasjen në sheshin “Isa Boletini” në Mitrovicë – të shtëna nga dy anët,



Personat që ndodheshin në banesë ishin larguar, ndërsa rasti ishte iniciuar si “Vrasje në tentativë”.

Hetimet më pas kishin çuar në identifikimin e disa personave të dyshuar. Më 20 gusht, Endri Cakiqi dhe Albi Cakiqi ishin vetëdorëzuar në Polici në praninë e avokatëve të tyre. Njëri prej tyre kishte dorëzuar edhe një pistoletë Zastava, për të cilën kishte pretenduar se ishte arma e përdorur në ngjarje.

Hetimet kishin çuar më pas edhe te persona të tjerë të dyshuar, ndërsa tre prej tyre kishin përfunduar para gjyqtarit të procedurës paraprake.

Dyve u ishte caktuar paraburgimi prej 30 ditësh, ndërsa njërit masa e arrestit shtëpiak.

Dorëzimi i Armend Hysenit dhe sekuestrimi i armës së dytë përbëjnë zhvillimin më të fundit në këtë rast.

Hetimet për të përcaktuar dinamikën e plotë të përplasjes, rolin individual të personave të përfshirë dhe armët e përdorura po vazhdojnë.

Shënim: Personat e apostrofuat në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

Mitrovicë

ARMA

ekskluzive

Fishekë

dorëzohet


të shtëna me armë

Policia e KOSOVËS

i dyshuar tjetër

Armend Hyseni

Të tjera:




Gjenerali Daniels në Mitrovicë: KFOR-i po përshtat pozicionimin e tij në veri

Siguri




Komandanti i MSU-së nga Ura e Ibrit: Mund të ndryshojë pozicionimi, por jo gatishmëria jonë

Siguri



Dy fshatra të Mitrovicës përfshihen nga zjarret, ekipet në terren për shuarjen e flakëve

Siguri



Lindje natyrale e rrallë në Mitrovicë – foshnja peshon 5 kilogramë e 50 gramë

Shëndetësi



Ekskluzive | Ky është i dyshuari për vjedhjen e 10 mijë € para e ari në Mitrovicë – kapet në...

Sinjalizime



Ekskluzive | Breshëri plumbash në një ndërtesë në Mitrovicë – qëllohet nga dy anët, d...

Sinjalizime



Shpëtohet mrekullisht fëmija pas rënies në ujë në një restaurant në Mitrovicë, dërgohet në...

Siguri



Gjendet pa shenja jete në banesën e saj në Mitrovicë, nis hetimi për vdekjen e 76-vjeçares

Sinjalizime

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të

përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtimi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketball
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitness
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera